

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 07 Rep.

NR. 01 Kol.



KONTRATE DHURIMI

Sot ne Tirane me date 11.01.2005 (dymije e pese) perpara meje noteres se Dhomes se Notereve, Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

(i) Z. Jonadri Shpetim Prodani, shtetas shqiptar, lindur me date 22.01.1978, banues ne adresen: Lagja nr. 2, Rruga A. Goga, P. 55, Durres, mbajtes i pasaportes me nr. 1100006, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruari, i cili ne kete kontrate, ne baze te prokures date 18.07.2004 (bashkengjitur) perfaqeson edhe vullnetin e Znj. Evis Shpetim Prodani, shtetase shqiptare, lindur ne Durres me date 03.01.1975; dhe (ii) Znj. Lela Shpetim Prodani, shtetase shqiptare, lindur me date 18.09.1984, banuese ne adresen: Lagja nr. 2, Rr. A. Goga, P. 55, Durres, mbajtese e pasaportes me nr. 1933145, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar: (te gjitha se bashku ne cilesine e *Dhuruesit*)

Dhe

Znj. Shpresa Neco Prodani, shtetase shqiptare, lindur me 12.02.1952, banuese ne adresen: Lagja nr. 2, Rr. A Goga Pall. 55, Durres, madhore e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e pasaportes me nr. 0653586 (ne cilesine e *Pranuesit*)

MEQENESE

- a) Ne baze te vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr. 30724/1 date 20.09.2004, palet e kesaj kontrate jane regjistruar si aksionere te shoqerise Banka Popullore Sh.a si zoterues te 87.5 aksioneve secili;
- b) Me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr. 30724/3 eshte kryer rritja e kapitalit themeltar te shoqerise Banka Popullore Sh.a duke e cuar numrin e aksioneve te zoteruara nga secili nga palet e kesaj kontrate ne 110 aksione secili me vlere nominale prej 100.000 Lek per aksion.
- c) Dhuruesit deshirojne te transferojne ne favor te Pranuesit pa kundershperblim, aksionet qe ata zoterojne ne shoqerine Banka Popullore Sh.a.;

ATEHERE

Meqenese ekzistojne kushtet si me siper, palet bien dakort per sa me poshte vijon:

Neni 1. Objekti i Kontrates

Sipas kushteve te parashikuara ne kete Kontrate, Dhuruesit i dhurojne Pranuesit dhe ky i fundit pranon prej tyre te gjitha aksionet qe Dhuruesit zoterojne ne shoqerine Banka Popullore Sh.a., si me poshte:

[Handwritten signatures]

[Handwritten signature: Shpresa Neco]

- Z. Jonadri Prodani i dhuron Znj. Shpresa Prodani, 110 aksione me vlere nominale Lek 100.000 per aksion;
- Znj. Evis Prodani i dhuron Znj. Shpresa Prodani, 110 aksione me vlere nominale Lek 100.000 per aksion;
- Znj. Lela Prodani i dhuron Znj. Shpresa Prodani, 110 aksione me vlere nominale Lek 100.000 per aksion;

Neni 2. Transferimi i Titullit

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, Pranuesi behet i vetmi titullar i ligjshem edhe i 330 (treqindetridhjetë) aksioneve te dhuruara nga dhuruesit, dhe se bashku me aksionet qe zoteronte me pare, arrin kuoten e 440 aksioneve qe perbejne 4.16% te kapitalit te shoqerise Banka Popullore Sh.a., dhe Dhuruesit zhvishen nga çdo e drejte mbi aksionet e dhuruara.

Neni 3. Te Ndryshme

Kjo Kontrate Dhurimi, se bashku me dokumentet qe i bashkengjiten, perbejne te gjithë marreveshjen midis paleve ne lidhje me objektin e mesiperm.

Neni 4. Ligji i Zbatueshem

Palet bien dakort qe kjo Kontrate do te zbatohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Per cfare nuk parashikohet ne kete Kontrate aplikohen dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise mbi dhurimin.

Kjo Kontrate Dhurimi e cila hartohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, pasi i lexohet paleve me ze te larte nga une Noteri, dhe pasi ata e gjeten permbajtjen e saj ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire, e nenshkruajne para meje dhe une Noteri e vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.

Dhuruesit:

Jonadri Prodani

Jonadri Prodani

Lela Prodani

Lela Prodani

Per Evis Prodani (Jonadri Prodani)

Jonadri Prodani

Jon

Pranuesi:

Shpresa Prodani

Shpresa Prodani

NOTERI

D. G. ...